



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



SHËRBIMI PËRMBARIMOR
GJYQËSOR PRIVAT

Nr. 601/6 Prot

Tiranë, më 09.03.2020

Nr. 687 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat "3H" SHPK, në referim të Urdherit të Ekzekutimit Nr.1764 Akti date 14.02.2020 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane , kam vene ne ekzekutim kete Urdher duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.687, kërkesën e Kreditorit- Subjekti Saimir Merepeza PF me Nipt PF L52012035D, për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv faturat tatimore, per Debitorin- Shoqeria " Aler Group " shpk me Nipt L81722027P dhe Administrator Z. Tetiana Bajraktari,

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin si dhe Njoftimin per deklarim që përmban Urdheri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile, kam kaluar në vënie sekuestros konservative tek pasuritë e tij, pasi konstatova se nuk respektoan afatin e këtij lajmërimi.

KONSTATOVA Se :

Debitori- Shoqeria " Aler Group " shpk me Nipt L81722027P dhe Administrator Z. Tetiana Bajraktari, ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e Shoqeria " Aler Group " shpk me Nipt L81722027P dhe Administrator Z. Tetiana Bajraktari në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të të Ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, te verifikojë dhe të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve nga:

Shoqëria " Aler Group " shpk me Nipt L81722027P dhe Administrator Z. Tetiana Bajraktari

2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

**SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "3 H" SHPK
PERMBARUES GJYQESOR
Haxhi ISMAILI**





REPUBLICA E SHQIPËRISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

Nr: 1764 Regj. Themeltar

V E N D I M

“PËR LESHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretarja gjyqësore Lusjana Fezollari, sot më datë 14. 02. 2020 mori në shqyrtim në dhomë keshillimi, çështjen civile me Nr. 1764 Regj. Themeltar, që i përket :

KERKUES :

SUBJEKTI “SAIMIR MEREPEZA”-person fizik me seli ne Tirane, Rruga “Mihal Duri”, Godina Nr. 61/1, me NIPT L52012035D.

OBJEKTI :

Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Faturat Tatimore të Shitjes: Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 ne vleren 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 ne vleren 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08. 2019 ne vleren 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 ne vleren 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 ne vleren 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 ne vleren 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 ne vleren 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 ne vleren 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 ne vleren 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 ne vleren 105. 521, 95 lek, te leshuara kundrejt shoqerise “Aler Group” sh.p.k, kamatat e vonuara dhe demshperblimin.

BAZA LIGJORE :

Nenet 510 - 511 të K. Pr. Civile me ndryshimet. Ligji Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, Neni 4, 5, 7, 11, 12, 16 i tij.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN :

Se, kërkuesi personi fizik « Saimir Merepeza» sh.p.k., ka paraqitur për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes; Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 ne vleren 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 ne vleren 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08. 2019 ne vleren 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 ne vleren 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 ne vleren 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 ne vleren 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 ne vleren 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 ne vleren 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 ne vleren 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 ne vleren 105. 521, 95 lek, te leshuara kundrejt shoqërisë “Aler Group” sh.p.k.

Nga administrimi i akteve rezultoi e provuar se :

Se, pala kërkuese “Saimir Merepeza”-person fizik është subjekt i se drejtes tregtare e regjistruar s’i person juridik që prej datës 12. 08. 2015, me objekt të veprimtarisë së tij tregtare ndër të tjera edhe në fushën e : *“tregtimin me pakice dhe shumice të artikujve ushqimorë. ...”*.

Në zbatim të veprimtarisë së saj tregtare ky subjekt rezultoi të ketë hyrë në një marrëdhënie kontraktore furnizimi, me shoqërinë “Aler Group” sh.p.k. Palet nuk kanë lidhur një kontratë formale shërbimi por me veprime konkludente midis paleve, kjo marrëdhënie ekziston si e tillë. Objekt i marrëdhënies rezultoi të ketë qenë furnizimi (shitja) e artikujve ushqimorë. Menyra e likuidimit do të jetë nga e nesërmja e datës se lëshimit të faturës tatimore.

Rezultoi se janë bërë disa transportime periodike në periudha të ndryshme kohore dhe për këto janë leshuar faturat respektive.

Kështu, fakti i sipërcituar provohet nga faturat tatimore e shitjes me Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 ne vleren 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 ne vleren 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08. 2019 ne vleren 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 ne vleren 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 ne vleren 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 ne vleren 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 ne vleren 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 ne vleren 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 ne vleren 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 ne vleren 105. 521, 95 lek, te leshuara kundrejt shoqërisë “Aler Group” sh.p.k.

Sipas pretendimeve të shprehura në kërkesë nga ana e personit fizik “Saimir Merepeza” nuk rezultoi që të jetë përmbushur detyrimi për pagimin e çmimit të përcaktuar në faturat tatimore të shitjes të sipërcituara edhe pas njoftimeve verbale e formale të kryera ndaj saj.

Për këtë shkak lidhur me këto fatura tatimore në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, sipas pales kërkuese, duhet të lëshohet urdhëri i ekzekutimit nga ana e gjykatës.

Cilësinë e titullit ekzekutiv, në kuptim të dispozitave procedurale mbi ekzekutimin e detyrueshëm e kanë vetëm aktet e përcaktuara sipas Nenit 510 të K. Pr. Civile. Në nenin 510 gërma “e” të K. Pr. Civile parashikohet shprehimisht se *konsiderohen tituj ekzekutivë të gjitha aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet Zyra e Përmbarimit për ekzekutimin e tyre.*

Në nenin 16 të Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, dispozitë kjo e emërtuar : *“Titulli ekzekutiv”* parashikohet shprehimisht se :

1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

- a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe
- b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile”.

Në rastin konkret në zbatim të dispozitave të sipërcituara rezultojnë që të plotësohen kushtet për të konsideruar faturat tatimore të shitjes me Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 në vlerën 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 në vlerën 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 në vlerën 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 në vlerën 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08. 2019 në vlerën 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 në vlerën 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 në vlerën 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 në vlerën 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 në vlerën 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 në vlerën 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 në vlerën 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 në vlerën 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 në vlerën 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 në vlerën 105. 521, 95 lek, të leshuara kundrejt shoqërisë “Aler Group” sh.p.k, për arsye se :

Pala kërkuese “Saimir Merepeza”-person fizik rezultojnë ta ketë ofruar shërbimin e saj me anë të furnizimit me mallrat e kërkuar ndaj shoqërisë “Aler Group” sh.p.k dhe kjo e fundit nuk rezultojnë që të ketë kundërshtuar shërbimet e ofruara nga ana e “Saimir Merepeza”-person fizik perkundrazi me anë të nenshkrimin të tyre, ka njohur dhe pranuar në teresi elementet e ketyre faturave persa i perket permbajtjes se tyre në sasi, vlerë per shërbimin e ofruar. Po kështu rezultojnë sipas librit të shitjeve të pales kërkuese të paraqitur si prove në gjykim, se keto fatura tatimore janë deklaruar si të tilla prane organeve tatimore.

Nuk rezultojnë që të jemi në kushtet e përcaktimeve të nenit 485 të K. Civil.

Në kuptim të përcaktimeve të nenit 16 të ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, faturat tatimore të shitjes Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 në vlerën 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 në vlerën 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 në vlerën 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 në vlerën 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08. 2019 në vlerën 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 në vlerën 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 në vlerën 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 në vlerën 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 në vlerën 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 në vlerën 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 në vlerën 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 në vlerën 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 në vlerën 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 në vlerën 105. 521, 95 lek, të leshuara kundrejt shoqërisë “Aler Group” sh.p.k. rezultojnë që të konsiderohen tituj ekzekutiv, për zbatimin e të cilit ngarkohet shërbimi përbarimor.

Gjykata arriti në këtë përfundim pasi analizoi faktin dhe në bazë të nenit të sipërpërmendur keto fatura përbëjnë tituj ekzekutiv.

Po kështu Neni 511 i K. Pr. Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 114/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", përcakton se : « Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi. Urdhri i ekzekutimit përmban: a) gjenealogjet e debitorit dhe kreditorit; b) origjinën e detyrimit; c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit; d) kur titulli

ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.



Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, gjykata vendos të pranojë kërkesën si të bazuar në ligj dhe në prova dhe të lëshojë urdhrin e ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes me Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 ne vleren 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 ne vleren 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 ne vleren 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08. 2019 ne vleren 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 ne vleren 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 ne vleren 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 ne vleren 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 ne vleren 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 ne vleren 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 ne vleren 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 ne vleren 105. 521, 95 lek, te leshuara kundrejt shoqerise "Aler Group" sh.p.k.

Rezulton se pala kërkuese së bashku me kërkesen objekt gjykimi, ka paraqitur dhe faturën tatimore të shitjes, nr. 1, datë 14. 01. 2020 në vlerën 36,000 lekë lëshuar nga av. Julian Shkjezi përkundrejt palës kërkuese për shërbim ligjor, e cila mbi bazën e porkurës Nr. 130 Rep, Nr. 30/2 Kol, datë 21. 01. 2020, ka paraqitur kërkesën për lëshim urdhëri ekzekutimi objekt gjykimi. Në lidhje me kërkimin e palës kërkuese për pagimin shpenzimeve avokatore në shumën 36, 000 lekë, në referim të neneve 511 të K.Pr. Civile dhe neneve 5, 11, 12 dhe 16/2 të ligjit nr. 48/2014, gjykata analizon si më poshtë.

Në Nenin 511 të K. Pr. Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 114/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", përcaktohet në mënyrë shteruese se ç'farë duhet të përmbajë urdhëri i ekzekutimit dhe konkretisht: "[...] Urdhri i ekzekutimit përmban: a) gjeneralitetet e debitorit dhe kreditorit; b) origjinën e detyrimit; c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit; d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare".

Gjykata vlerëson se sipas parashikimit ligjor të mësipërm si pjesë të urdhrin të ekzekutimit janë edhe kamatat ligjore të detyrimit të përcaktuar në faturat tatimore të shitjes objekt gjykimi, të cilat llogariten sipas nenit 5 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare".

Ndërkohë, sa i takon kërkimin të palës kërkuese për shpenzimet në kuptim të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare" ti ngarkohet palës debitore, gjykata vlerëson se këto shpenzime nuk mund të jenë pjesë disponimit në urdhërin e ekzekutimit.

Në Nenin 11 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", të titulluar "Shpërblimi i shpenzimeve për rikthimin e kredisë" parashikohet se "Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën. Shpenzimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni llogariten si kosto shtesë ndaj shumës që ka lindur për shkak të pagesës së vonuar dhe përfshijnë çdo shpenzim të provuar të kreditorit, që ai ka kryer kundrejt avokatëve, shpenzime të tjera ligjore të kryera për të bërë të mundur arkëtimin e pagesës, si dhe çdo shpenzim të paguar prej tij për të vënë në ekzekutim pagimin e shumës së detyrimit".

Ndërkohë në Nenin 12 i Ligjit nr. 48/2014, nën titullin "Pagimi i shpenzimeve" parashikohet se:

"Në rastin e pagesës së vonuar, debitori ka detyrimin për të paguar në favor të kreditorit, përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, edhe një dëmshpërblim në shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Kjo shumë është e pagueshme menjëherë, pa qenë nevoja e kryerjes së ndonjë njoftimi nga kreditori për pagimin e saj".

Nga ana tjetër në nenin 16 të ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", dispozitë kjo e emërtuar : "Titulli ekzekutiv" parashikohet shprehimisht se :

"1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

- a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe*
- b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.*

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile".

Sa më sipër gjykata vlerëson se shpenzimet avokatore të bëra nga pala kreditore janë detyrimisht të ekzekutueshme në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv (që janë faturat tatimore të shitjes) dhe i ngarkohen palës debitore. Ky ekzekutim duhet të bëhet nga përbaruesi gjyqësor në kuptim të nenit 16/2 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare" dhe nenit 525/1 të K. Pr. Civile në fazën e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit. Por, gjykata e gjen të pabazuar në nenin 511 të K. Pr. Civile kërkesën e palës kërkuese për përfshirjen e këtyre shpenzimeve në urdhrin e ekzekutimit. Sipas këtij neni në urdhër përfshihen a) detyrimi monetar që përbën titullin ekzekutiv që në rastin konkret në të nenit 16/1 të ligjit nr. 48.2014 janë faturat tatimore të shitjes, si dhe a) kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare. Kështu ky shpenzim avokatie i parapaguar nga kreditori për bërjen të mundur të ekzekutimit të detyrimit monetar duhet të përfshihet në shpenzimet e ekzekutimit të llogaritura nga përbaruesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit.

Po ashtu sa i takon shpenzimeve gjyqësore të përcaktueshme si taksa për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit ekzekutiv, pra në shumën 200 lekë (taksë pulle), parapaguhet nga pala kërkuese dhe në kuptim të nenit 525 të K. Pr. Civile përbaruesi gjyqësor kur vë në ekzekutim titullin ekzekutiv për të cilin është lëshuar urdhëri ia ngarkon palës debitore.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata bazuar në Nenet 306 e vijues, 510 gërma "e" dhe 511 gërma "ç" të K. Pr. Civile, s'i dhe në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare",

VENDOSI :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për Faturat Tatimore të Shitjes Nr. 8660 datë 16. 09. 2019 në vlerën 51. 618, 52 lek; Nr. 8655 dt. 16. 09. 2019 në vlerën 73. 632, 6 lek; Nr. 8348 dt. 07. 09. 2019 në vlerën 17. 686, 9 lek; Nr. 8349 dt. 07. 09. 2019 në vlerën 10. 041, 9 lek; Nr. 8077 dt. 31. 08.

2019 ne vleren 129. 072, 8 lek; Nr. 8076 dt. 30. 08. 2019 ne vleren 69. 866, 7 lek; Nr. 7831 dt. 23. 08. 2019 ne vleren 75. 153, 25 lek; Nr. 7860 dt. 24. 08. 2019 ne vleren 81. 844 lek; Nr. 7623 dt. 17. 08. 2019 ne vleren 26. 441 lek; Nr. 7545 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 142. 930, 96 lek; Nr. 7542 dt. 15. 08. 2019 ne vleren 34. 904, 25 lek; Nr. 7443 dt. 13. 08. 2019 ne vleren 61. 638, 8 lek; Nr. 7414 dt. 12. 08. 2019 ne vleren 15. 852, 5 lek; Nr. 7384 dt. 10. 08. 2019 ne vleren 105. 521, 95 lek, të lëshuara nga ana e

Kreditorit: SUBJEKTI "SAIMIR MEREPEZA"-person fizik me seli ne Tirane, Rruga "Mihal Duri", Godina Nr. 61/1, me NIPT L52012035D.

qe shprehin detyrimin e,

Debitorit: Shoqeria "Aler Group" sh.p.k. me NIPT KL41307075M,L81722027P me seli ne Tirane, Rruga Teodor Keko, Pallati Nr. 6, Ap. 6, kati i dyte, me perfaqesuese ligjore zj. Tatiana Bajraktarii.

si dhe mbi kete detyrim te cituar ne vlerat e faturave te mesiperme, te perlogariten nga permbaruesi gjyqesor ne fazen e ekzekutimit, kamatat ligjore ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, konkretisht sipas Nenit 5 te Ligjit Nr. 48/2014 dt. 24. 04. 2014 «Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare ».

3. Ngarkohet Sherbimi Permbarimor të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
4. Ky vendim hartohet vetëm në një kopje.
5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet të bëhet ankim.
7. U shpall sot më datë 14. 02. 2020 në Tirane.

SEKRETARE

LUSJANA FEZOLLARI



Shpenzime gjyqesore

<u>Takse mbi aktet</u>	<u>200 lek</u>
Totali	200 lek

GJYQATAR

ERVIN POLLOZHANI

